



Republika e Kosovës/Republika Kosova/Republic of Kosovo
Qeveria/Vlada/Government
Ministria e Punëve të Jashtme / Ministarstvo Inostranih Poslova / Ministry of Foreign Affairs
Akademia Diplomatike / Diplomatska Akademija / Diplomatic Academy

Ambassade de France au Kosovo

Memorandum i Bashkëpunimit

në mes të

Akademisë Diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme

Republika e Kosovës

dhe

Ambasadës së Francës në Kosovë

Akademia Diplomatike në Ministrinë e Punëve të Jashtme, Republika e Kosovës, *Rruga Luan Haradinaj, 10000, Prishtinë, Kosovë*, e përfaqësuar nga drejtori, z. Skender DURMISHI, referuar tutje në këtë Memorandum të Bashkëpunimit si Akademia Diplomatike, DHE Ambasada e Francës në Kosovë, *Rruga Ismail Qemali nr 67, 10000, Prishtinë, Kosovë*, e përfaqësuar nga Zëvendës-Ambasadorja, znj. Lise MOUTOUMALAYA, referuar tutje në këtë Memorandum të Bashkëpunimit si Ambasada e Francës, pajtohen si në vijim:

Neni 1
Qëllimi

Qëllimi i këtij Memorandumi të Bashkëpunimit është bashkëpunimi rreth orëve të subvencionuara apo kurseve që do të organizohen nga Ambasada e Francës për sesionin e dytë 2015, për diplomatët e regjistruar në Akademinë Diplomatike.

Neni 2
Shërbimet

Akademia Diplomatike dhe Ambasada e Francës pajtohen për shërbimet si më poshtë:

1. Ambasada e Francës organizon një sesion të kurseve për semestrin e dytë të vitit 2015;
2. Ky sesion i kurseve do të përfshijë kurse të frëngjishtes të niveleve A1 dhe A2 të Kornizës së Përbashkët Evropiane të Referencës për Gjuhët, për dy grupe pjesëmarrëse;

Neni 3
Formimi i grupeve pjesëmarrëse

Formimi i grupeve pjesëmarrëse do të propozohet nga Akademisë Diplomatike. Palët pajtohen që tre pjesëmarrës të jenë nga Ministria e Integritimit Evropian dhe tre pjesëmarrës nga Ministria e Diasporës, të Republikës së Kosovës.

Neni 4
Implikimet financiare

Akademia Diplomatike dhe Ambasada e Francës përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit janë pajtuar si vijon:

1. Sesioni plotësisht të financohet nga Ambasada e Francës;
2. Sesioni përfshin dy kurse javore prej 1 orë e 30 min, për grupin e nivelit A1, dhe dy kurse javore prej 1 orë e 30 min për grupin e nivelit A2;
3. Kurset do të zgjasin 10 javë: nga data 19.10.2015 deri më 11.01.2016. Gjithsej 30 orë për secilin grup;
4. Kurset do të mbahen nga një mësues, gjuha amtare e së cilës është frëngjishtja;
5. Materiali pedagogjik, përveç librave, do të ofrohet nga Ambasada e Francës;
6. Për pjesëmarrësit për grupin e nivelit A2, Ambasada e Francës, do të financojë abonimin vjetor në mediatekën e Aleancës Franceze në Prishtinë;

Neni 5
Vendi i mbajtjes së kurseve

Akademia Diplomatike dhe Ambasada e Francës përmes këtij Memorandumi të Bashkëpunimit janë pajtuar si vijon:


1. Kurset do të mbahen në hapësirat e Akademisë Diplomatike, përkatësisht në sallat e Ministrisë së Punëve të Jashtme. Megjithatë, deri sa të përfundojnë punimet në këto salla, kurset do të mbahen në hapësirat e Aleancës Franceze në Prishtinë.
2. Akademia Diplomatike angazhohet të sigurojë që salla në të cilën mbahen kurset, të jetë e pajisur me një CD player dhe një tabelë të bardhë për shkrim;
3. Akademia Diplomatike merr përsipër lëshimin e certifikatës së kurseve të përfunduara, për çdo pjesëmarrësi në fund të sesionit të kursit.

Neni 6
Mbikëqyrja e pjesëmarrësve

1. Pjesëmarrësit angazhohen të jenë të pranishëm të paktën 8 orë të mësimit gjatë tërë sesionit.
2. Në rast të mungesës së pamotivuar të një pjesëmarrësi në më shumë se 6 orë të mësimit, Ambasada e Francës rezervon të drejtën e anulimit të regjistrimit të tij;

Nënshkruar më 12 nëntor 2015, në Prishtinë, në katër kopje origjinale, dy në gjuhën shqipe dhe dy në gjuhën frënge.

Për:
Akademinë Diplomatike në Ministrinë
e Punëve të Jashtme, Republika e Kosovës



Z. Skender Durmishi
Drejtor

Për:
Ambasadën e Francës në Kosovë



Znj. Lise MOUTOUMALAYA
Zëvendës-Ambasadore